

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e Kërkesës nr. 01, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni administrativ, ndaj kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje zonjës Eriselda Sefa, propozuar nga Partia Socialiste””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** z. Erdal Mema, znj. Ina Osmanaj, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
 1. **Qëndresa Qytetare:** z. Rigels Xhemollari,
znj. Teisa Kurti.
 2. **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:**
znj. Antoneta Njehrrëna, znj. Nexhila Kodra.
 3. **Vëzhgues:** **KRIK**

Z. I. Rusmali: Nisim seancën e shqyrtimit për Kërkesës nr. 1, dt. 23.05.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Vendosje sanksioni administrativ, ndaj kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje zonjës Eriselda Sefa”. Prezent në këtë seancë janë përfaqësuesit e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. në emër të administratës tagrat e përfaqësimit do t’i ketë zonja Blerta Ereqi, e cila është autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm që ta kryejë këtë detyrë, apo jo?

Znj. B. Ereqi: Përshëndetje, po! Duke qenë se Sekretari i Përgjithshëm sot gjendet në raportim pranë Kuvendit të Shqipërisë, autorizohem unë nëpërmjet autorizimit që do t’ua paraqes në dosje, për përfaqësimin e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me denoncimin e datës 26 shkurt 2022, me numër ID unik 3598. Në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar ky denoncim

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

ku pretendohet se “Në datë 16.02.2022, në Spitalin e Lushnjës, konkretisht në praninë e kandidatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, për kryetare të Bashkisë Lushnje, zonjës Eriselda Sefa, e cila aktualisht mban postin e kryetares në detyrë, drejtuesi politik i Partisë Socialiste...

Z. I. Rusmali: Blerta të lutem, prezantojmë dhe palët e tjera, pastaj do të jap fjalën ty që të bësh prezantimin e plotë të kërkesës, dakord?

Znj. B. Ereqi: Në rregull, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Në emër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjës Ogerta Manastirliu kanë ardhur gjithashtu për ta përfaqësuar, ju lutem prezantohuni!

Znj. A. Njehrrrena: Antoneta Njehrrrena, drejtorëshë e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Z. I. Rusmali: Faleminderit!

Znj. N. Kodra: Nexhila Kodra, përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve Juridike dhe Administrative.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Gjithashtu për protokoll, zonjat që të dyja kanë autorizim për të përfaqësuar në këtë çështje dhe Sekretaren e Përgjithëshme të institucionit, apo jo?! Dakord, shumë mirë! Gjithashtu prezent janë edhe përfaqësuesit e Qëndresës Qytetare.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. R. Xhemollari: Rigels Xhemollari, drejtor ekzekutiv.

Znj. T. Kurti: Gjithashtu Teisa Kurti, juriste me autorizim.

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit shumë! Kërkesë paraprake për trupën gjyquese nga ana e palëve, ka? Dmth në qoftë se ndonjë nga palët ka kundërshti për anëtarët e trupës, për konflikt interesi, mund ta thotë tani! Mund ta bëjë një kërkesë të tillë. Nuk ka! Kolegët në se kanë për të bërë ndonjë deklaram? Nuk kanë! Në rregull, atëherë kthehemi te ju Blerta! Ju lutem prezantoni pak kërkesën që ka ardhur nga Komisioneri Shtetëror!

Znj. B. Ereqi: Përshëndetje dhe njëherë! Ju bëj me dije se pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 26 shkurt 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi unik me ID 3598, ku pretendohet se “Në datë 16.02.2022, në Spitalin e Lushnjës, konkretisht në praninë e kandidatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, për kryetare të Bashkisë Lushnjë, zonjës Eriselda Sefa, e cila aktualisht mban postin e kryetares në detyrë, drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun e Fierit, zoti Taulant Balla dhe Ministrija e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Ogerta Manastirliu, vizituan ambientet e Spitalit të Lushnjës me rastin e investimeve të zhvilluara në atë institucion spitalor. Ky aktivitet vjen në një kohë, që përkon me fushatën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në një veprimtari të ndaluar, në referime dhe të nenit 3, pika 1.1/b të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Rregullator, ku kanë promovuar investimet me interes publik, aktivitet i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore”. Bashkëlidhur denoncimit janë paraqitur edhe provat, të cilat janë të cituara edhe në vendim, edhe në denoncimin përkatës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 168, dt.19.05.2022, në përfundim të shqyrtimit administrativ, ka vendosur: Përfundimin e këtij shqyrtimi administrativ. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, ndaj zonjës Ogerta Manstirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga ana e zotit Pjerin Vogli Drejtori i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnje. Konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor nga ana e zonjës Eriselda Sefa, kryetare bashkie dhe njëkohësisht kandidate për kryetare në Bashkinë Lushnje, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Për këtë arsye, në pikën 4 të vendimit i kërkon Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e një sanksioni administrativ. Pas shortit të hedhur në datën 23.05.2022, relator i kësaj çështje është caktuar zoti Ilirjan Rusmali, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Ndoshta duhet të dëgjojmë palët, çfarë kanë për të thënë paraprakisht, pastaj ju bëjmë pyetjet! Fillojmë me palën që ka bërë denoncimin fillimisht, me Qëndresën Qytetare! Çfarë keni për të thënë ju, mundësisht shkurt lidhur me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror?

Z. R. Xhemollari: I nderuar zoti Relator! Ne pretendojmë se në denoncimin që kemi bërë në datën 26 shkurt, kemi kallëzuar një shkelje të nenit 91, 92 të Kodit Zgjedhor. Ku drejtues të administratës publike, në orar zyrtar, marrin pjesë në një veprimtari të ndaluar, brenda një aseti publik. Promovojnë investime me interes publik, që është sterilizimi, apo laboratorit i ri i analizave. Bëjnë premtime për investime të ardhshme

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

në prani të kandidatës Sefa, e cila pranon me shkresë zyrtare se “vizita e saj është tërësisht në funksion të fushatës elektorale”. Ky aktivitet bëhet në prani të drejtuesit politik të qarkut të Partisë Socialiste, zotit Taulant Balla. Ajo që ne kemi si kundërshtim me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, qëndron në disa pika:

Së pari, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nga provat e administruara, kandidatja Sefa ka përdorur ambjentin e spitalit dhe ka përdorur me detyrim administratën publike në orar zyrtar, në mbështetje të kësaj fushate zgjedhore. Si ka mundësi që konstatohet përdorimi i administratës publike dhe nuk konstatohet shkelje për drejtorin e spitalit dhe ministren e shëndetësisë? Administratë e cila është përdorur në këtë rast.

Së dyti, në rastin e vendosjes së gjobës për zonjën Sako, pra rasti pararendës për të njejtën shkelje neni 91, pika 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i referohet nenit 172 të Kodit Zgjedhor ku gjoba varion nga 1 në 5 milion lekë të vjetra. Ndërsa për këtë rast, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ju kërkon ju, vendosjen e sanksionit administrativ referuar nenit 171, pika 1 subjekt i të cilit janë anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe persona të njohur me detyra zgjedhore. Pra, këtu kemi të bëjmë me një gjykim dhe standard të dyfishtë.

Së treti, instuticionet kanë detyrim të raportojnë aktivitetet me karakter publik para datës së zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se ky aktivitet nuk është një veprimtari e ndaluar dhe e bazon këtë në dy argumenta: së pari thotë se ky aktivitet është zhvilluar ndërmjet palëve të interesuara dhe prania e medias ka qenë në kuadër të transparencës së këtij aktiviteti instuticional. Ky aktivitet është publikuar edhe në katër media kombëtare si “Balkanweb”, “Panorama” etj., që do të thotë mesazhi, apo ligjërimi i këtij aktiviteti ka shkuar te të gjithë qytetarët, edhe tek ata që kanë qenë votues në Bashkinë Lushnje. Së dyti, kandidatja shprehet në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

shkresën e saj se “nuk mund të përjashtohen pacientët nga fushata”. Pra, janë takuar persona, votues brenda në spital duke i dhënë aktivitetit një karakter politik. Argumenti i dytë në të cilën Komisioneri e bazon këtë për veprimtari jo të ndaluar thotë se “ministri ka qenë duke kryer detyrat e tij funksionale, si inspektime, takime me specializantë”. Atëherë, në qoftë se ministri ka qenë në këtë detyrë çfarë bën drejtuesi politik i fushatës së Fierit, zoti Taulant Balla, në një takim të ministrit me specializantë, apo me stafin e vet? Çfarë bën kandidatit për kryetare të Bashkisë Lushnje, në këtë takim të ministrit me zyrtarët e tjerë që i ka në varësi? Pra, kemi të bëjmë me një aktivitet të karakterit politik dhe veprimtari të ndaluar, pasi ministri në qoftë se do të informojnë se kjo i përket një aktiviteti elektorale, atëherë duhet ta ndalonte dhe jo ta promovonte në rrjetet sociale, në media etj., etj.. Kështu që ne i qëndrojmë kallëzimit tonë se ministrja e shëndetësisë, zonja Ogerta Manastirliu, drejtori i spitalit Lushnje, janë vënë në dispozicion të fushatës së kandidatit Sefa. Kanë vendosur asetin në dispozicion dhe nuk kanë raportuar për aktivitetin sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Për rrjedhojë ne kërkojmë: vendosjen e masës administrative për kandidatin Sefa, sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor dhe jo sipas nenit 171/1. Masën administrative për ministren e shëndetësisë dhe drejtorin e spitalit për vendosjen në dispozicion të aseteve në funksion të kandidatit, por dhe për mosraportim të aktivitetit të ndaluar. Gjithashtu masë administrative për Partinë Socialiste për shkelje të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Xhemollari! Ju do të shtoni gjë, apo nuk ka nevojë? Nuk ka nevojë! Mirë, përfaqësueset e ministres dhe sekretares së përgjithshme të institucionit, çfarë kanë për të thënë në lidhje me kërkesën por dhe reagime në lidhje dhe me pretendimet e shprehura nga denoncuesi?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Znj. N. Kodra: Faleminderit, siç u tha dhe këtu, referuar denoncimit që është bërë, ose kërkesës së Qëndresës Qytetare, kemi vijuar me dy koorespondencat tona dhe i qëndrojmë të njëjtit qëndrim që nuk jemi para rastit të veprimtarive të ndaluara. Në lidhje me raportimin për veprimtaritë me karakter publik, kemi përmendur kështu aktet rregullatore. Në përgjigje të denoncimit që është bërë ku thuhet që “është marrë pjesë në veprimtari të ndaluara, apo është bërë një promovim i investimit me karakter publik, nuk jemi në këto raste. Këtu përmendim vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjithashtu dhe Kodin Zgjedhor. Në vendimin nr. 9 përcaktohet shumë mirë se cilat janë veprimtaritë e ndaluara. Janë “të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për publikun, apo median në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjekte të përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë karakter informimi në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjes, e publikut rreth tyre”. Në koorespondencën tonë, ne kemi sqaruar lidhur me veprimtaritë e ndaluara, të cilat parashikohen në mënyrë kategorike në nenin 3 të vendimit nr. 9. Ato ndahen në veprimtari të ndaluara për t’u promovuar dhe veprimtari e ndaluar. Veprimtari e ndaluar për t’u promovuar është shumë i qartë kriteri ligjor ku thuhet që “janë veprimtari publike sipas përkufizimit të nenit 3 që ne e cituam më lart, për të cilat janë vënë rishtazi, apo në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo të planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë një sërë veprimtarish mbështetje promovimi projektsh”. Pra, thelbi është vendosja në dispozicion për të qenë para kushtit të ndalimit ligjor të jenë vendosur rishtazi, apo posaçërisht në dispozicion, apo të jenë transferuar fonde publike jo sipas një plani buxhetor të miratuar dhe kjo të përkojë me 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Në lidhje me këtë ne themi që, nuk jemi para këtij rasti të ndalimit ligjor. Nuk kemi një veprimtari publike të ndaluar për t’u promovuar, sepse sipas denoncimit konkret që ju i jeni referuar në lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

konstruksionin e spitalit të Lushnjes se asaj i përmbahemi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin atakues, nuk janë vendosur rishtas, apo posaçërisht në dispozicion, apo të jenë transferuar fonde publike, jo sipas një plani buxhetor të miratuar në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Data e zgjedhjeve ka qenë 6 Mars 2022, rikonstruksioni i godinës së urgjencës së spitalit të Lushnjes është një kontratë publike. Është produkt i një procedure të prokurimit publik, e cila është zhvilluar në bazë të ligjit të vitit 2006 të prokurimit publik dhe VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo do të thotë që është zhvilluar një procedurë prokurimi publik në një moment të caktuar, ka konkluduar të gjitha peripeçitë e saj dhe ka përfunduar me lidhjen e një kontrate. Kjo kontratë është e datës 26. 01.2021. Kjo do të thotë që sipas kësaj reference dhe këtij informacioni që ne japim nuk kemi vënë në dispozicion fonde rishtazi në lidhje me ndalimin ligjor 4 muaj para zgjedhjeve. Është një procedurë që ka qenë në vazhdim, është konkluduar me lidhjen e një kontrate dhe ky është historiku i rikonstruksionit të godinës së urgjencës së spitalit të Lushnjes. Në lidhje me veprimtaritë e ndaluara, në lidhje me pikën 1.3 që thotë vendimi 9 i Komisionit Rregullator, edhe këtu nuk vlerësojmë se jemi para një veprimtarie të ndaluar ku thuhet që “ministri, administrata gjatë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve e kanë të ndaluar të drejtojnë, marrin pjesë, apo të kontribuojnë në veprimtaritë publike të ndaluara sipas këtij vendimi”. Dëshirojmë të sjellim në vëmendje që neni 3 i vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator për veprimtaritë e ndaluara ka një listë të mbyllur dhe shterruese në lidhje me veprimtaritë e ndaluara ligjore. Kjo do të thotë që kjo listë e mbyllur nuk mund të ketë më tejkalim, apo devijacione, apo vend për interpretim. Në këtë rast ne vlerësojmë se nuk jemi para listës së mbyllur të ndalimeve që parashikon neni 3. Pra, nuk jemi në ndalimet ligjore të nenit 3 ku citohen të gjitha aktivitetet e ndaluara. U përmend edhe çështja e raportimit të veprimtarive publike. Në lidhje me këtë,

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

dëshirojmë të sjellim në vëmendje parashikimin ligjor të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, i cili referon te pika 1, neni 92 i Kodit Zgjedhor. Ku veprimtaritë publike thuhet “janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias.”, në kuptim të pikës 1 neni 92 të Kodi Zgjedhor, “.. që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”. Ne kemi vlerësuar që nuk kemi pas një veprimtari në kuptimin e një veprimtarie sipas kuptimit të nenit 2. Këto i kemi sqaruar edhe në korespondencat tona. Kemi vlerësuar se nuk jemi para një rasti të një veprimtarie me karakter publik, të hapur me pjesëmarrjen nga publiku, apo media dhe si e tillë nuk jemi para nenit 2 të vendimit nr. 9. Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje përtej parashikimit ligjor lidhur dhe me qëllimin e raportimit. Në nenin 9, pika 1 të vendimit të Rregullatorit parashikohet që qëllimi i raportimit është që të ndalojë një veprimtari publike që raportohet kur përbën ndalime ligjore sipas nenit 3 të aktit të rregullatorit. Tani, a kemi një veprimtari të ndaluar ne në rastin tonë? Ne kemi sqaruar se nuk kemi veprimtari të ndaluar sipas nenit 3 dhe ajo që është publike është e ndaluar. Ne nuk e kemi vlerësuar se jemi para një veprimtarie publike sipas përkufizimit të nenit 2 që e sqaruam më sipër, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit zonja Kodra! Pyetje? Ndoshta po filloj unë me përfaqësuesit e Qëndresës Qytetare. Ju kërkoni vendosjen e sanksionit administrativ ndaj ministres për pjesëmarrje në një veprimtari të ndaluar siç e kuptova unë dhe për mosraportim. Mund të na thoni referencën ligjore si për pjesën që i ndalon ministres pjesëmarrjen, si atë që e detyron ministren të raportojë dhe në qoftë se ju e keni mundësinë të na orientoni edhe dispozitat. Referencat ligjore që për secilën nga këto

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

shkelje ngarkojnë KQZ-në me detyrimin për të vendosur sanksione sipas rastit specifik. Në qoftë se i keni, në qoftë se nuk i keni, nuk është problem.

Znj. T. Kurti: Patjetër i nderuar! Ne i kemi paraqitur këto edhe në parashtrimet tona. Unë do të doja të sillja në kujtesë konkretisht për këtë çështje nenin 6, pika 3 e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator thotë shprehimisht se “Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni, ose kandidati në zgjedhje”. Në këtë rast, zonja Manastirliu në cilësinë e ministres e pranuar kjo edhe nga kthim-përgjigjja e institucioneve si një nga organet më të larta të administratës shtetërore që e thotë ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, ka marrë pjesë në një aktivitet. Një veprimtari me karakter publik me qëllim informimin...

Z. I. Rusmali: Kjo është e qartë. Kjo është dispozita që ia ndalon përdorimin e aseteve shtetërore. Dispozita që e ndëshkon për përdorimin e aseteve shtetërore, cila është?

Znj. T. Kurti: Në gjykimin tonë, dispozita që e ndalon këtë është neni 91 i Kodit Zgjedhor, i cili në analogji sanksionohet me nenin 172 të Kodit Zgjedhor...

Z. I. Rusmali: Neni 172, thoni ju? Ministrja nuk është subjekt zgjedhor, cili paragraf? Gjithnjë në qoftë se..., detyra jonë është t’u lejojme të orientohemi, e juaja është të na ndihmoni. Në qoftë se na ndihmoni dakord, në qoftë se jo, nuk është problem.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Znj. T. Kurti: Pika 2 e nenit 172, germa “dh”, thotë “fakti se në këtë shkelje kanë marrë pjesë persona zyrtare, ose janë shfrytëzuar burime publike”. Pjesëmarrës në këto aktivitete kemi persona zyrtarë, të cilët pasi kanë marrë dijeni që drejtuesi i qarkut të Partisë Socialiste., zonja Sefa, kandidatja pranon në shkresat e saj se pjesëmarrja e tyre ka qenë tërësisht në funksion të zgjedhjeve. Kanë pas detyrimin ta ndalojnë menjëherë aktivitetin, ose të mos lejonin marrjen pjesë të...

Z. I. Rusmali: Dakord, e kuptova! Mirë, po për pjesën tjetër, për mosraportimin, kush është referenca juaj ligjore? Ka pas detyrimin për raportimin ministrja dhe çfarë ndëshkimi parashikon kodi kur nuk raportohet?

Znj. T. Kurti: Në këtë rast neni 92 i Kodit Zgjedhor parashikon se, institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe agjensitë janë të detyruara të raportojnë në KQZ, të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Ne gjykojmë...

Z. I. Rusmali: Më tutje?

Znj. T. Kurti: ..që kjo veprimtari ka karakter publik. Formojnë veprimtari publike, të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin. Në këtë rast kemi publikimin në disa media të këtij aktiviteti...

Z. I. Rusmali: Dakord, detyrimi është i institucionit për këtë gjë?

Znj. T. Kurti: Po i institucionit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. I. Rusmali: Dakord! Sanksioni në këtë rast kush është?

Znj. T. Kurti: Neni 171 i Kodit Zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Kjo është në bazë të nenit 171?

Znj. T. Kurti: Në gjykimin tonë.

Z. R. Xhemollari: Dhe të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, i cili parashikon gjoba.

Z. I. Rusmali: Dakord, e qartë! Mirë faleminderit! Edhe një pyetje tjetër ndoshta, unë mbaroj me ju me këtë pyetje. Ju praktikisht, keni sjellë provat tuaja në mbështetje të denoncimit. Pra, ju keni administruar të parët fotot dhe pamjet video nga aktiviteti, apo jo? Në analizën që i keni bërë, ju keni identifikuar, në ato foto dhe pamje video, ministren, drejtuesin e qarkut dhe kandidaten. Drejtuesin e spitalit e keni identifikuar në ato foto?


Znj. T. Kurti: Po, ndodhet dhe drejtori i spitalit që i shoqëron.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Znj. T. Kurti: Dua të mos le pa përmendur edhe drejtorin e spitalit i cili gjithashtu kishte detyrimin ...

Z. I. Rusmali: Dakord, në vlerësimin tuaj, drejtori i spitalit shoqëron të gjithë trupën.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Znj. T. Kurti: Po!

Z. R. Xhemollari: Drejtori i spitalit është personi në mes te fotoja. Kandidatja, zoti Balla, ministrja dhe ky është drejtori i spitalit.

(Shënim i stenografes: demonstroi me foto)

Z. I. Rusmali: Dakord, e kuptova. Ju identifikoni personin në atë foto, i cili është në mes të fotografisë. E njejtat pyetje për administratën e KQZ-së. Gjatë hetimit administrativ e keni identifikuar në këtë aktivitet drejtorin e spitalit? Në qoftë se keni dijeni, në qoftë se jo s'ka problem.


Znj. I. Osmanaj: Është identifikuar, të them të drejtën, nëpërmjet fotos.

Z. I. Rusmali: Dakord! Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Meqenëse jemi te raportimi, kam një pyetje për përfaqësuesit e Qëndresës. Detyrimin për raportim e ka pas vetëm Ministria e Shëndetësisë, apo edhe drejtori i spitalit, edhe kryetaria e bashkisë në cilësinë e kryetares dhe jo kandidatet? Kush sipas jush ka pas detyrimin? Të gjithë së bashku e kanë pas detyrimin për raportim, apo vetëm njëri nga subjektet?

Znj. T. Kurti: Në fakt, kjo nuk është e qartë dhe për ne se rast pas rasti është parë që nga praktika, detyrimin për raportim e ka pas organizatori i aktivitetit. Në gjykimin tonë nuk e ka vetëm organizatori, por edhe bashkia si institucion i qeverisjes vendore. Në shkresat kthim-përgjigje, shihet që organizatore ka qenë ministria e cila

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

ka pas në agjendë, promovimin e inagurimit. Drejtori i spitalit madje thotë që “ka qenë në agjendë inagurimi i qendrës Gradisht”, e cila për hir të së vërtetës Gradishta është njësi administrative e Divjakës. Pjesëmarrja e kandidates për kryetare e Bashkisë Lushnje, shihet e pavend.

Z. I. Rusmali: Siç e kemi kuptuar ne, inagurimi i Qendrës Shëndetësore Gradisht, është një aktivitet tjetër, përmendet në shkresë për të lidhur kronologjikisht aktivitetet e ministres. Besoj se ky është leximi, apo jo përfaqësuesit e ministrisë?!

Znj. N. Kodra: Po!

Z. I. Rusmali: Nuk është objekt i hetimit tonë Gradishta. Në dijeninë e përfaqësuesve të ministrisë, për datën 16 ka pas raportime nga Ministria e Shëndetësisë në faqen e raportimeve?

Znj. N. Kodra: Në lidhje me rastin konkret, në fakt siç e kemi sqaruar, bazuar te neni 2, nuk e kemi vlerësuar se jemi para një veprimtarie me karakter...

Z. I. Rusmali: Këtë e kuptova! Të lutem, nuk ju pyeta për këtë, ju pyeta për ditën, agjendën e ditës?

Znj. N. Kodra: Jo, s’ka pas raportime!

Z. I. Rusmali: Pra, s’ka pas raportime. Përgjigjen tuaj e kuptuam. Ju thoni që sa kohë që nuk është aktivitet publik nuk kemi pse e raportojmë?!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Znj. N. Kodra: Po!

Z. I. Rusmali: Nga ana tjetër nga shkresat e ministrisë thuhet “në vijim ministria, ka preferuar...,” për të qenë në rregull me gjithshka, “.. të raportojë të gjitha aktivitetet e ministres, pavarësisht nëse ishin publike, apo jo publike”. Është e vërtetë kjo!?

Znj. N. Kodra: Po!

Z. I. Rusmali: Dakord! Ligji, Kodi Zgjedhor përgjegjësinë e raportimit ja ngarkon sekretarit të përgjithshëm. Pavarësisht se ka një praktikë administrative me KQZ-në dhe institucionet, që këto të fundit ngarkojnë gjithnjë një njeri që të bëjë punën, por përgjegjësia ligjore është e sekretarit të përgjithshëm për raportimin. Ndaj dhe sekretari i përgjithshëm është ftuar sot të marrë pjesë në këtë seancë shqyrtimi. Në dijeninë tuaj sekretari i përgjithshëm, ka qenë në dijeni të aktivitetit të ministres atë ditë? Aq sa dini!


Znj. N. Kodra: Nuk kam dijeni për këtë çështje.

Z. I. Rusmali: Po, zoti Braho!

Z. L. Braho: Ndoshta mund ta formulojmë pyetjen ndryshe se zonjat janë juriste, drejtoresha dhe përgjegjësja e sektorit. A është në kompetencat e sekretarit të përgjithshëm organizimi i aktiviteteve të tilla, ose marrja dijeni për aktivitete të tilla?

Znj. A. Njehrrrena: Sekretari i përgjithshëm është një strukturë administrative e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa për sa i përket pjesës së organizimit të agjendës

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

së ministres, të veprimtarive, kryesisht ngarkohet kabineti i ministrit të shëndetësisë. Sekretari është më shumë për pjesën organizative të administratës së Ministrisë së Shëndetësisë duke qenë dhe titullari më i lartë në funksionet administrative.

Z. I. Rusmali: Po mirë atëherë, si i del zot sekretari i përgjithshëm përgjegjësisë së vet ligjore, kur organizimi i agjendës së ministrit është çështje e kabinetit? Apo se keni trajtuar ndonjëherë këtë çështje?


Znj. A. Njehrrrena: Në këndvështrimin tonë, agjenda e ministrit sigurisht lidhet dhe me funksionin administrativ, mënyra e lëvizjes, pjesa e administratës që do të lëvizë bashkë me ministren. Kështu që, patjetër janë të ndërthurura, por për sa i përket organizimit të agjendës në këndvështrimin tonë është pjesë e kabinetit. Sekretari i përgjithshëm është në funksion të zbatimit të agjendës. Për sa i përket pjesës administrative.

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër nga kolegët? Po zoti Lako!

Z. E. Lako: Kam një pyetje për ankuesit, për Qëndresën. Doli pjesa e fotove, prova që keni depozituar për aktivitetin dhe drejtori i spitalit. Çfarë keni konkretisht me atë foto? Se unë shoh një grup, drejtori i spitalit, ministrja që janë në mjediset e spitalit duke inaguruar në pjesën e investimeve që janë bërë në atë spital. Dmth, për çfarë akuzohet drejtori i spitalit? Pse ka shoqëruar në mjediset e spitalit ministren? Pra, cila është logjika e asaj fotos që e keni sjellë si provë, kjo është?

Znj. T. Kurti: Faleminderit! Në fakt nuk e di sa normale është që në një burim publik, në një aset publik siç është spitali, kandidatja pranon shkresërisht që në atë aktivitet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

ka qenë vetëm për arësye elektorale. Pra, pranoi që në atë burim publik është kryer takim elektorale. Provë për këtë...

Z. E. Lako: Nuk ka të bëjë me shkresën, as me foton. Shoh personin që ju keni identifikuar si drejtor i spitalit, ndodhet në mjediset e spitalit dhe po shoqëron ministren. Më bën përshtypje çfarë prove është kjo? Çfarë keni dashur të provoni me këtë, sepse edhe unë po të isha drejtor spitali e të më vinte ministri, do ta shoqëroja ministrin. Pra, çfarë keni treguar me atë provë, ku është qëllimi i kësaj prove?

Znj. T. Kurti: Më falni në qoftë se nuk jam e qartë! Drejtori i spitalit, në një moment që merr dijëni se në atë spital po kryhet një aktivitet elektorale, duhet ta lejojë, apo duhet ta ndalojë? Duhet t'i shoqërojë?


Z. I. Rusmali: Pretendimi juaj është që drejtori i spitalit duhet t'i mbyllte derën ministrit dhe shkakun ligjor për këtë e kishte?

Znj. T. Kurti: Po!

Z. I. Rusmali: Guximshëm!

Z. L. Braho: Në fakt pyetja do të shkonte më shumë për përfaqësuesit e Bashkisë Lushnje, spitalit. Meqenëse nuk i kemi ata, unë përsëri nuk arrij të kuptoj qëllimin e aktivitetit. Vetë zonja Sefa në dy shkresa të ndryshme pranon që aktiviteti zhvillohej për qëllime të ndryshme. Në shkresën e datës 3 mars 2022, që i ka kthyer Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve thotë që “Në vijim të fushatës dhe premtimeve zgjedhore, nuk mund të shmangnim as qytetarët që marrin kushte kurimi në spitale”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Pra, këtu e sqaron se ka qenë për qëllime fushate. Ndërkohë në shkresën e datës 10 mars., kjo e 3 marsit është dërguar si Eriselda Sefa. Kjo e 10 marsit është dërguar me logon e Bashkisë Lushnje, ku thotë “Në ambjentet e spitalit Lushnje, i cili ndodhet në territorin e Bashkisë Lushnje, ka qenë prezent ministrja e shëndetësisë për një takim konsultues me mjekët specializantë të këtij spitali, të cilët janë në përfundim të kontratës së tyre. Kryetarja e bashkisë në detyrë, ka qenë prezent në këtë takim për t’i ofruar ndihmën e Bashkisë Lushnje, duke u ofruar bonusin e qerasë për mjekët të cilët nuk janë me banim në Bashkinë Lushnje. Kjo është një politikë sociale, me anë të së cilës Bashkia Lushnje do të japë kontributin e saj në pasjen e një stafi të specializuar”. Tani, ky takimi ka qenë për mjekët specializantë, ka qenë për rikonstruksionin e spitalit Lushnje, ka qenë për fushatën e kandidatës për kryetare bashkie? Pra, ministrja me çfarë qëllimi ka shkuar në këtë aktivitet, mirë kandidatja nuk e ka ndarë se kush ka qenë qëllimi i aktivitetit? Ju në cilësinë e përfaqësueses së ministres mund të na e ndani?

Znj. N. Kodra: Në fakt, ky aktivitet ka qenë një veprimtari e ushtrimit të detyrës, lidhur me mjekët specializantë që u ka përfunduar kontrata. Pastaj objekt denoncimi ka qenë ai postimi në rrjetin social. Në vijim të kësaj ne kemi dhënë sqarimet.

Z. L. Braho: Statusi i ministres pastaj thotë “Me drejtusin politik të Qarkut Fier, Taulant Balla dhe kryetarja e Bashkisë Lushnje Eriselda Sefa, pamë nga afër urgjencën e rehabilituar dhe laboratorin modern që bashkë me sterilizimin me parametra bashkëkohorë kanë përmirësuar cilësinë e shërbimit për banorët e Lushnjes”. Statusi pastaj flet për gjë tjetër, nuk flet fare për mjekët specializantë. Statusi është i datës 16 shkurt. Në cilësinë e detyrës së ministres, nuk e di se sa legjitime është të përmendet edhe drejtuesi politik i Qarkut të Fierit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. I. Rusmali: Keni një përgjigje për këtë reagim të kolegut?

Znj. N. Kodra: Jo nuk kam!

Z. I. Rusmali: Dakord, përfaqësuesi i Qëndresës Qytetare, kërkon të reagojë!

Znj. T. Kurti: Në fakt për shtesë, në videon që ne kemi sjellë në cilësinë e provës, që është një video rreth 10 minuta, në asnjë moment nuk përmenden as mjekët specializantë dhe as nuk shihen pjesëmarrës në këtë takim.

Z. I. Rusmali: Dakord, e kuptuam! Po zoti Çefa!

Z. E. Çefa: Një pyetje të fundit kam unë, thjesht nga përfaqësuesit e ministrisë, cila është procedura e emërimit të drejtorit të spitalit, nga kush emërohet?


Znj. A. Njehrrrena: Nga ministri i shëndetësisë.

Z. I. Rusmali: Kemi pyetje të tjera?

Z. L. Braho: Edhe një pyetje për përfaqësuesen e Qëndresës Qytetare. Thatë që nuk shihen pjesëmarrës. E kishit fjalën për mjekët specializantë, kur thatë që nuk shihen pjesëmarrës?

Znj. T. Kurti: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. L. Braho: Ndërkohë aty janë pjesëmarrës edhe persona që janë për kurim në spitalin e Lushnjës?

Znj. T. Kurti: Në këtë foto është e dukshme që po përshëndesin edhe pacientët..

Z. R. Xhemollari: Mund ta shihni edhe në video! (*shënimi stenografes: afrohet me celular t'u tregojë videon*)

Z. I. Rusmali: Nuk është nevoja, e kemi dhe është kot se nuk e shohim dot nga celulari videon. Ne e kemi parë videon, ndoshta do ta shohim përsëri gjatë konsultës. Rrini pa merak për këtë gjë. Ju që jeni marrë.., nuk e di se sa ka mundësi të përgjigjen përfaqësuesit e ministrisë, por në qoftë se përgjigjen do të jetë shumë mirë. Gjatë pamjeve video që ne kemi parë, dalin individë që shoqërojnë aktivitetin duke bërë foto, ose duke filmuar. Ne nuk jemi në gjendje ta themi këtë. Këta individë i keni identifikuar cilët janë? Janë media, personel i ministrisë, staf i drejtuesit politik? Keni ndonjë të dhënë për ta?

Znj. T. Kurti: Për të qenë të sinqertë ne nuk jemi në gjendje t'i identifikojmë, si pjesë e procesit hetimor duhet t'i kishte trajtuar...

Z. I. Rusmali: Dakord! Përfaqësueset e ministrisë janë të gjendje të thonë, apo se keni parë fare videon?

Znj. N. Kodra: Nuk e kemi parë videon.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. I. Rusmali: Dakord, përfaqësuesit e administratës, e keni bërë identifikimin e këtyre?


Znj. B. Ereqi: Nuk kemi të dhëna.

Z. I. Rusmali: Në qoftë se do të bëj dhe unë një pyetje të fundit për administratën, se besoj i kemi të qarta gjërat tani. Përfaqësuesit e Qëndresës Qytetare kundërshtuan klasifikimin ligjor që i keni bërë ju shkeljes. Nuk duhet të jetë neni 171, por duhet të jetë neni 172. Ka një reagim për këtë nga ana e administratës, ju duket i pranueshëm argumenti, apo nuk qëndron?

Znj. B. Ereqi: I nderuar zoti Kryetar, për momentin nuk kemi një reagim tonin, pasi unë konkretisht nuk jam marrë me dosjen. Personi përgjegjës që është marrë me dosjen nuk është prezent. Nuk mund t'ua them me siguri që është përcaktim i nenit 171, apo 172.

Z. I. Rusmali: Dakord, pa problem! Pyetje tjetër nga kolegët? Mund të kalojmë te pretendimet përfundimtare lidhur me këtë çështje, sepse pyetje nuk ka. Fillojmë me administratën që është kërkuesi. Cili është qëndrimi juaj përfundimtar, çfarë kërkoni nga KAS-i?

Znj. B. Ereqi: Në përfundim të gjithë prapësimeve që u paraqitën këtu, kërkojmë: vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa, kandidate për kryetare dhe njëkohësisht kryetare e Bashkisë Lushnje, në vlerën pesëdhjetë mijë lekë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Z. I. Rusmali: Dakord, Qëndresa Qytetare!

Z. R. Xhemollari: Ne i qëndrojmë kallëzimit tonë të parë. Kërkojmë masë administrative për kandidaten zonjën Sefa. Masë administrative për ministren e shëndetësisë dhe drejtorin e spitalit Lushnje dhe masë administrative për Partinë Socialiste si subjekt zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Përfaqësueset e ministrisë!

Znj. N. Kodra: Në lidhje me pretendimet përfundimtare, ne i qëndrojmë deklarimeve që kemi bërë. Kërkojmë të merret parasysh që ne besojmë se kjo nuk është veprimtari e ndaluar në kuptim të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu dhe parashikimet ligjore lidhur me raportimin e veprimtarive të karakterit publik dhe qëllimin e raportimit, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit, për ta mbyllur përfundimisht, para se ne të tërhiqemi. Si relator, unë kam identifikuar në rrethin e provave që do të na shërbejnë ne për të gjykuar mbi këtë gjë.


Së pari, denoncimin e paraqitur nga Qëndresa Qytetare, në të dy format si denoncim në portal dhe denoncimin e protokolluar.

Shkresën nr.1099/1 dt.4.03.2022 të ministres së shëndetësisë që jep shpjegim lidhur me çështjen në shqyrtim.

Shkresën nr.1672/1, dt.14.04.2022 të sekretares së përgjithshme të ministrisë, e cila i përgjigjet kërkesës së Komisionerit. Praktikisht shpjegon dhe njëherë të njejtat gjëra.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.05.2022*

Shkresën e zonjës Eriselda Sefa të datës 3.03.2022 drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Shkresën nr. 1964/1, dt.10.03.2022 të kryetares së bashkisë Lushnje, që e citoi kolegu pak më parë.

Shkresën nr. 372, dt.10.03.2022 të drejtorit të spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnje.

Gjithashtu në cilësinë e provës kam shtuar provat link të paraqitura në këtë denoncim dhe provat link të paraqitura në pretendimet përfundimtare të Qëndresës Qytetare. Pra, edhe postimi në “Balkanweb.com” edhe postimi në “Fjala.al”. Videon në Youtube nuk e gjeta, më rezultonte e hequr nga Youtube. Në qoftë se ju dini të na e referoni, mund të na e paraqesni tani, para se ne ta mbyllim, por video nuk më rezultonte, ajo që ishte si referencë aty. Keni nevojë të kërkonit ndonjë provë tjetër që të shqyrtohet nga ana jonë?


Znj. T. Kurti: Nga ana jonë jo!

Z. I. Rusmali: Ministria ka nevojë të kërkojë ndonjë gjë tjetër?

Znj. N. Kodra: Jo!

Z. I. Rusmali: As ministria s’ka! Besoj dhe administrata s’ka! Ju çfarë kishit për të dhënë i keni dhënë! Mirë mund ta mbyllim këtu shqyrtimin dhe të tërhiqemi për të marrë vendim?! Dakord! Mbyllim këtu shqyrtimin dhe do të marrim vendimin. Besoj se ne na duhen 30 minuta për të rifilluar seancën. Në orën 12:20 riçelim seancën për të dhënë vendimin, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.31.05.2022

Rifillon seanca

Ora 12:24

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën. KAS në përfundim të hetimeve administrative, vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr.1, datë 23.05.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnje, zonjës Eriselda Sefa”. Vendosjen e sanksionit administrativ, mbështetur në pikën 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor, në vlerën njëqind mijë lekë.

2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjës Gelardina Prodani mbështetur në pikën 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, në vlerën njëzet e pesë mijë lekë.

3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Drejtorit të Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje, zotit Pjerin Vogli mbështetur në pikën 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, në vlerën dy mijë e pesëqind lekë.

4. Pushimin e procedimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

5. Pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjës Ogerta Manastirliu.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Senca mbyllet, ju faleminderit!

Vendimi nr. 19

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

